

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-080/2014

**Prishtinë
14 Prill 2016**

Në çështjen juridike të:

U.K. DOO

Përfaqësuar nga Avokati A.V.

Prishtinë

Pala ankuese

kundër

I.G.

Rr.Artim Jashari, nr.12

Mitrovicë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtaret Beshir Islami, Kryetari i Kolegjit, Anders Cedhagen dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/216/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA13394), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 14 Prill 2016 mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e U.K. DOO kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/216/2013, e datës 21 gusht 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/216/2013, i datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA13394.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 7 shtator 2006, M.R. , në cilësinë e përfaqësuesit të subjektit juridik “U.K. DOO” (më tej: pala ankuese) paraqiti një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (më tej: AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së pronësisë, ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzimin e paligjshëm të një depoje me sipërfaqe prej 330m2, që ndodhet në rrugën Marshall Tito PN në Mitrovicë (më tej: prona e kërkuar). Pala ankuese deklaroi se data e humbjes së pronës është 12 qershori 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese në AKP paraqiti:
 - Një kontratë të lidhur më 20 korrik 1998 ndërmjet “Raj-Banka” a.d.Pejë dhe NSH “Pećka Pivara”. Bazuar në marrëveshjen e tyre, NSH “Pećka Pivara” i ka pasur borxh “Raj-Bankës” a.d.Pejë dhe si kompensim për këtë borxh, kompania ia ka dorëzuar pronën e kërkuar “Raj-Bankës” a.d.Pejë. Kontrata nuk është verifikuar në gjykatë.
 - Një vendim nr.17774/2005 të datës 4 gusht 2005, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, që tregon një kërkesë për regjistrimin e Kompanisë U.K. Doo që është miratuar dhe se pala ankuese është e shënuar si njëri nga themeluesit e kësaj kompanie.
 - Një vendim gjykate nr.FI-403/97 të datës 15 maj 1997 mbi regjistrimin e kompanisë “U.K.” d.o.o. Ky vendim është lëshuar nga Gjykata Ekonomike e Prishtinës.

3. Nga Raporti i Konsoliduar i Verifikimit të datës 5 prill 2012, është verifikuar pozitivisht vetëm vendimi i gjykatës nr.FI-403/97 i datës 15 maj 1997, i lëshuar nga Gjykata Ekonomike e Prishtinës.
4. Njoftimi i kërkesës është bërë më 25 qershor 2013. Prona është gjetur e uzurpuar nga I.G. (më tej: pala përgjegjëse në kërkesë), i cili ishte i pranishëm në pronë. Pala përgjegjëse në ankesë pretendoi të drejtë ligjore mbi pronën dhe e nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes më 28 qershor 2013. Pala përgjegjëse në ankesë dorëzoi një përgjigje ndaj kërkesës më 3 korrik 2013. Për ta mbështetur përgjigjen e tij, pala ankuese dorëzoi në AKP kontratat për shitjen e dhe transferimin e pronave që ndodhen në Mitrovicë dhe me sipërfaqe të ndryshme nga ajo e pronës së kërkuar.
5. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tej: KKPK), përmes vendimit KPCC/D/C/216/2013 e refuzoi kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 37), KKPK-ja theksoi se pala ankuese nuk kishte arritur të paraqet ndonjë provë që ka mundur të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive, se bartësi i së drejtës mbi pronën e kërkuar i gëzon të gjitha të drejtat pronësore mbi pronën e kërkuar.
6. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese më 20 dhjetor 2013. I njëjti vendim iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 6 dhjetor 2013. Më 17 janar 2014, pala ankuese paraqiti ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Një kopje e ankesës iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 28 prill 2014. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme ta prishë vendimin e KKPK-së dhe t'ia njoh të drejtat pronësore palës ankuese mbi pronën e kërkuar. Në ankesë, pala ankuese sugjeron se vendimi i KKPK-së bazohet në vërtetim të gabuar dhe të mangët të gjendjes faktike si dhe gabim thelbësor pasi që është në kundërshtim me të drejtën materiale dhe procedurale. Pala ankuese shpjegoi se kërkesa e tij bazohet në kontratën e transaksionit të lidhur ndërmjet Raj Bankës dhe ish-pronarit të pronës së kërkuar, Fabrika e Birrës në

Pejë. Përmes kësaj kontrate, Fabrika e Birrës në Pejë pranoi që t'ia jap pronën e kërkuar Raj Bankës në shkëmbim të borxhit që kishte për ta paguar. Pala ankuese më tej shpjegoi se themeluesi i Raj Bankës ishte vet kompania Udarnik Komerc. Për këtë arsye pala ankuese pretendon se ka qenë pronar i pronës së kërkuar.

Arsyetim ligjor

Pranueshmëria e ankesës

8. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (më tej: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).

Meritat e ankesës

9. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i kundërshtuar i KKPK-së është lëshuar në bazë të përcaktimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë janë zbatuar në mënyrën e duhur si e drejta materiale ashtu edhe e drejta procedurale. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
10. Pala ankuese pretendon se e ka fituar pronësinë mbi pronën e kërkuar në bazë të një marrëveshjeje. Dokumentet relevante të paraqitura nga pala ankuese janë verifikuar negativisht. Meqë kontrata është verifikuar negativisht, ky dokument nuk do të konsiderohet se dëshmon të drejta ligjore të palës ankuese dhe për ta argumentuar kërkesën për ri-posedim.
11. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme vlerëson se ekzaminimi i provave dhe vlerësimi i tyre është bërë saktë nga KKPK-ja dhe asnjëra nga dokumentet e dorëzuara nga pala ankuese e dëshmojnë pronësinë e tij mbi pronën e kërkuar.
12. Prandaj, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i kundërshtuar i KKPK-së vërtetohet si i saktë dhe i bazuar në ligjin e zbatuar si duhet.

Konkludim

13. Në përputhje me nenin 13.3.(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenit 195, paragrafi 1(d) i Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

14. Ky Aktgjykim nuk e paragjykon të drejtën e palës ankuese që ta referojë lëndën e tij në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetari i Kolegjit

Anders Cedhagen, Gjyqtar i EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it